



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Beledijesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



01 Nr. 020/22
Më datë: 28.09.2022
Mamushë

Në bazë të nenit 40 pika 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kuvendi i Komunës së Mamushës në mbledhjen e mbajtur me 28.09.2022 mori këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të objektit të Shtëpisë së Kulturës, Policisë së Republikës së Kosovës-Stacioni Policor në Mamushë

I

Në mbledhjen e mbajtur më 28.09.2022 Kuvendi i Komunës së Mamushës ka marrë vendim për dhënien në shfrytëzim të objektit të Shtëpisë së Kulturës në ngastrën kadastrale nr.187-0 dhe me sipërfaqe prej 2800m².

II

Dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të Shtëpisë së Kulturës sikurse në nenin 1, jepet për një periudhë 10(dhjetë) vjeçare dhe pa kurrfar kompensimi, me mundësi të rikthimit të objektit në shfrytëzim të komunës me kusht që të njëjtëve të ju sigurohet një hapësirë tjetër e përshtatshme.

III

Pjesë e këtij vendimi janë edhe kopja e planit të ngastrës kadastrale si dhe hapësira e ndarë për shfrytëzim sikurse në nenin 1.

IV

Ky vendim hynë në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen :

- Policia e Kosovës –MPB
- MAPL-ja
- Kryetari të Komunës
- Drejtorja për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm dhe Gjeodezi-Kadastër
- Drejtorja e Shërbimeve Publike
- Arkivi

Kryesuesi i Kuvendit

Necmedin Morina

